



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:098532
Datë: 01.02.2024
Numri i dokumentit: 05270391

C.nr.3392/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtarin Baki Shigjeqi dhe bashkëpunëtorin profesionale H.D. duke vendosur në çështjen juridiko- kontestimore të paditësve Z.D., A.D., M.D., D.D., V.D.1., V.D.2., J.D. dhe V.D.3. që të gjithë me vendbanim në Prizren, të cilët me autorizim i përfaqëson E.R. avokat nga Prizreni, kundër të paditurit A.D. nga fshati ... komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson B.K. avokat nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të pronësisë, vlera e kontestit 100,000.00 euro, pas seancën së shqyrtimit kryesor-publik, në prani të paditëses Z. . dhe autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datë 17.11.2023, mori, ndërsa me datë 01.02.2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve Z.D., A.D., M.D., D.D., V.D.1., V.D.2., J.D. dhe V.D.3. që të gjithë me vendbanim në Prizren
- II. VËRTETOHET** se paditësit Z.D., A.D., M.D., D.D., V.D.1., V.D.2., J.D. dhe V.D.3. që të gjithë me vendbanim në Prizren, në bazë të përfaqësimit të të ndjerit H.D. janë pronarë secili nga 1/32 pjesë ideale e paluajtshmërisë në parcelën kadastrale numër P-71813068-5655/3, ZK Prizren, arë e klasës së II, në sipërfaqe prej 697 m², ashtu që **DETYROHET** i padituri A.D. nga fshati komuna e Rahovecit, që ta prnojë këtë fakt dhe të lejojë paditësit që të regjistrohen si pronarë në librat kadastralë dhe atë në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbaramit të dhunshëm.
- III.** Pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësve Z.D., A.D., M.D., D.D., V.D.1., V.D.2., J.D. dhe V.D.3. që të gjithë me vendbanim në Prizren, përtej pjesës së aprovuar si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e deri në pjesën ideale të kërkuar nga 1/8, të pjesës ideale të paluajtshmërisë, refuzohet si e pabazuar.
- IV.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Ar sy e t i m

1. Historiku i Çështjes dhe Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit Z.D., A.D., M.D., D.D., V.D.1., V.D.2., J.D. dhe V.D.3. që të gjithë me vendbanim në Prizren, të cilët me autorizim i përfaqëson E.R. avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë paraqitur padi, të cilën e kanë precizuar me parashtresën e datës 04.10.2023, kundër të paditurit A.D. nga fshati komuna e Rahovecit, të cilin me autorizim e përfaqëson B.K. avokat nga Prizreni, për shkak të vërtetimit të pronësisë, vlera e kontestit 100,000.00 euro.

Fillimisht, Gjykata Komunale në Prizren ka marrë aktgjykimin me shenjë C.nr.60/03, të datës 08.07.2005, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, si në aktgjykimin e lartcekur. Ndërsa Gjykata e Qarkut në Prizren, me aktvendimin me shenjë AC.nr.172/2006, të datës 06.10.2006, e ka aprovuar ankesën e të paditurve dhe aktgjykimi me shenjë C.nr.60/03, i datës 08.07.2005, është prishur dhe lënda është kthyer në procedurë të serishme.

Pas kësaj, Gjykata Themelore në Prizren ka marrë aktgjykimin me shenjë C.nr.493/2008, të datës 06.08.2013, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, si në aktgjykimin e lartcekur. Ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin me shenjë AC.nr.3830/13, të datës 20.09.2017, e ka aprovuar ankesën e të paditurve dhe aktgjykimi me shenjë C.nr.493/2008, i datës 06.08.2013, është prishur dhe lënda është kthyer në rigjykim.

Pas kthimit të lëndës në rigjykim, Gjykata Themelore në Prizren, me datën 30.04.2021, ka marrë aktvendimin me shenjë C.nr.1284/2017, me të cilin e ka ndërprerë procedurën në këtë çështje juridike kontestimore për shkak të vdekjes së të paditurit A.S. ish nga Prizreni. Ndërsa me parashtresën e datës 14.06.2021, është bërë vazhdimi i procedurës dhe paditësit e kanë tërhequr padinë ndaj të paditurit tani të ndjerë A.S. Pas kësaj me aktvendimin C.nr.1129/21, të datës 22.11.2021, përsëri është ndërprerë procedura kontestimore, për shkak të vdekjes së të paditurit T.N. ish nga Prizreni. Ndërsa me parashtresën e datës 29.08.2022, është bërë vazhdimi i procedurës dhe paditësit e kanë tërhequr padinë ndaj të paditurit tani të ndjerë T.N.

Me parashtresën e datës 04.10.2023, i autorizuari i paditësve avokat E.R. e ka bërë precizimin e padisë në kuptimin objektiv dhe subjektiv dhe është tërhequr kërkesëpadija për ndaj ish të paditurave T.N., A.S. dhe pasardhësve të tyre si dhe ndaj të paditurve N.dhe B.N. me objekt kontesti anulimin e kontratës dhe ka qëndruar pranë kërkesëpadiisë për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, ndaj të paditurit A.D. nga fshati Celinë, komuna e Rahovecit.

Edhe gjatë shqyrtimeve të mbajtur pas kthimit të çështjes në rigjykim, i autorizuari i paditësve E.R. avokat nga Prizreni, ka qëndruar në tërësi pranë padisë, duke theksuar se tani i ndjeri-bashkëshorti dhe babai i paditësve me kontratë të pa legalizuar, njëra e datës 24.06.1989 dhe tjetra me datës 19.06.1988, ka blerë patundshmërinë e cila është objekt i shqyrtimit. Tani ish i padituri D.G. pranon se patundshmërinë në fjalë ia ka shitur H. Kontrata e legalizuar

Leg.II.nr.47/2000, e datës 09.10.2000, është nënshkruar dhe legalizuar nga ana e të paditurit A.D. dhe shitësve T., B. dhe A. të cilët në deklaratat që kanë dhënë pranë gjykatës kanë thënë se fare nuk e njohin palën me të cilën kanë lidhur kontratë, pra këtu A. Parat e çmimit të shitblerjes shitësve i ka dhënë këtu D.G. shumën siç është kontraktuar në nenin II të kontratës të datës 24.06.1989, pra kontrata e shitblerjes është lidhur mes shitësve dhe këtu tani të ndjerit H. dhe se i padituri A.D. e ka shfrytëzuar rastin që pas vdekjes së H. të lidhë kontratë me shitësit të cilët më herët kanë lidhur kontratë me tani të ndjerin H. dhe se ata tani blerësin A. nuk e njohin. Sa i përket vërejtjeve të gjykatës së Apelit, sipas aktvendimit të datës me shenjë AC.nr.3830/13, me të cilin është anuluar aktgjykimi se këtu palët në procedurë eventualisht kanë qenë në bashkësi familjare, ka theksuar se këtu tani i ndjeri H. gjatë jetës ka lidhur edhe kontrata të tjera dhe këto patundshmëri sot trashëgimtarët e tij e kanë në emër të vet dhe kjo tregon se në momentin kur janë bërë shitblerjet, nuk ka qenë bashkësi e përbashkët familjare, në këtë drejtim gjykatës si provë është procesverbali i gjykatës komunale C.nr.832/06, të datës 15.11.2007, me të cilin është arritur një ujdë lidhur me një patundshmëri, po ashtu në këtë drejtim kemi edhe listën poseduese ose certifikatën e pronësisë P-71813068-05653-2 ZK Prizren, nga e cila vërtetohet se djali i tani të ndjerit Vatan e ka pronën në emër të vet. Po ashtu kemi një aktgjykim të gjykatës komunale në Prizren C.nr.60/03, të datës 08.07.2005, me të cilën vërtetohet se H.D. ka blerë një patundshmëri e cila evidentohet në emër të tij, pra të gjitha këto prova tregojnë se në mes ndërgjyqëse nuk ka pas një bashkësi familjare dhe se secili e ka poseduar pronën e vet. Prandaj edhe në kontratën me shkrim të lidhur në mes tani të ndjerit H. edhe shitësve T.N. etj., theksohet se blerësi është që nga fillimi deri në lidhjen e kontratës së dytë në posedim. Andaj konsiderojnë se tani i ndjeri ka qenë pronarë i patundshmërisë kontestuese të cilën tani duhet të trashëgojë këtu paditësit.

Në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, në shqyrtimin e datës 17.11.2023, i autorizuari i paditësve avokat E.R. ka theksuar se këtu i padituri A.D. nuk e mohon faktin se patundshmërinë e cila është objekt i shqyrtimit ka blerë tani i ndjeri H.D. bashkëshort i paditëses Z. respektivisht babai i paditësve të tjerë dhe se i padituri pas shitblerjes ka lidhur kontratë me ish pronarët dh patundshmërinë e ka regjistruar në emër të vet. I njëjti thekson se kjo patundshmëri është pronë e përbashkët. Këtë deklaram e mbështet edhe përfaqësuesi i të paditurit A. në përgjigjen e dhënë. Prandaj shtrohet pyetja e lirshmërisë të kontratës Leg.nr.47/2000, të datës 09.10.2000, të legalizuar pranë Gjykatës Komunale në Prizren dhe evidentimi i kësaj prone në emër të paditurit A.D. në evidencat kadastral. Tutje ka shtuar se nga provat të cilat janë proceduar gjatë shqyrtimit kryesor dhe atë nga: kontrata mbi shitblerjen e datës 24.06.1989, vërtetohet se si blerës i patundshmërisë kontestuese është tani i ndjeri H.D. bashkëshorti i paditëses Z.D. respektivisht babai i paditësve të tjerë. Ndërsa nga kontrata e datës 19.06.1998, vërtetohet se ish pronarët e kësaj patundshmëria konfirmojnë se është bërë shitblerja se është paguar çmimin i shitblerjes. Të hollat pronarëve i ka paguar D.G. në emër të blerësit (për ndryshe D.G. në kontratën e vitit 1989 paraqitet si shitës. Këtë e ka bërë në emër të pronarëve të vërtetë). Në nenin dy të kësaj kontrate theksohet se blerësi H.D. që nga lidhja e kontratës me 1989, është në shfrytëzimin dhe posedimin e patundshmërisë. Kontrata Leg.nr.47/2000, e datës 09.10.2000, e lidhur në mes të ish pronarëve N. dhe S. në një anë si shitës dhe A.D. në anën tjetër si blerës (këtu i paditur) është lidhur në lajthim ashtu si që deklaroi përfaqësuesi i familjes N. avokat A.J. në procesverbalin e datës 17.09.2009 ku

thekson: se “klientët e tij kanë rënë në lajthim nga ish kolegu tani i ndjerë I.Ç. i cili i ka thënë se kontrata është djegur. Shitësit nuk kanë ditur se kujt po ja bëjnë bartjen”. Nga këto prova rrjedhë se pronarë legjitim i patundshmërisë që është objekt i shqyrtimit janë këtu paditësit në bazë të përfaqësimit nga tani i ndjeri bashkëshorti i paditëses Z.D. respektivisht babai i paditësve të tjerë i cili ka lidhur kontratën dhe ka pagur çmimin e shitblerjes. Pala e paditur me qëllim që të manipuloj me rastin ka paraqit një deklaratë të noterizuar, me numër rendor LRP 757/2013, të datës 02.04.2013, të dhënë nga paditësi V.D. Nga deklaratë rrjedh se V.D. njëri nga paditësit, në atë kohë ka pasur vetëm 20 vjet. Në atë deklaratë ka pranuar se patundshmëria që është objekt i shqyrtimit është pronë e përbashkët. Kjo deklaratë është e kushtëzuar. Kushti është se të gjitha pronat do të konsiderohen të përbashkëta, njeri prej kushteve është që të brenda 2 vitesh xhaxhai R.D. të ndërtoj një shtëpi 150 m2 dhe të paguaj qiranë e banesës në Prizren. Shtëpia nuk është ndërtuar, qiraja nuk paguhet e as që i është dhënë diçka nga prona e përbashkët në fshatin Andaj, kjo deklaratë nuk mund të pranohet si provë lidhur me pronën kontestuese, por shërben për të vërtetuar gjendjen faktike se familja edhe deri sa H.D. ka qenë gjallë dhe bashkësia ka funksionuar, pronën e kanë pasur të ndarë.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar, si në parashtrësën të cilën ia ka bashkangjitur fjalës përfundimtare.

Edhe gjatë shqyrtimeve të mbajtur pas kthimit të çështjes në rigjykim, i autorizuari i të paditurit A.D., avokat B.K. ka qëndruar pranë përgjigjes në padi, duke theksuar nuk kontestohet fakti se i padituri ka një kontratë të shitblerjes për patundshmërinë kontestuese nga shitësi, kontratë kjo e cila ka prodhuar efekte juridike, është e legalizuar në gjykatën kompetente, edhe përkundër kësaj se e njëjta prodhon efekte juridike dhe se pronari i vetëm i kësaj patundshmërie është këtu i padituri A.D. i njëjti që nga fillimi i procedurës ka deklaruar se pos tjerash se kjo paluajtshmëri edhe pse figuron në emër të tij është pronë e përbashkët e familjes D. të cilin fakt e kanë vërtetuar të gjithë trashëgimtarët ligjor të cilët janë dëgjuar në këtë gjykatë pas vërejtjeve dhe sugjerimeve që ka dhënë gjykata e Apelit me aktvendimin AC.nr. 3830/13, të datës 20.09.2017, për veç këtyre trashëgimtareve dhe dëshmitarëve këtë fakt se kjo pasuri edhe tërë pasuria e familjes D. është pasuri e përbashkët e ka pohuar edhe vetë nga njëri paditësi, biri i të ndjerit V.D. I cili në deklaratën e dhënë para zyrës noteriale me nr. rendor LRP.nr.757/13, datë 02.04.2013, i njëjti deklaroi se kjo pasuri është pasuri e përbashkët e familjes D. Deklaratë kjo që është pjesë e shkresave të lëndës. Faktin se këto pasuri janë pasuri e përbashkët e familjes D. e krijuar gjatë bashkësisë familjare dhe se në kohën kur është blerë kjo patundshmëri Familja D. ka jetuar në bashkësi familjare, të cilin fakt e ka vërtetuar edhe paditësja Z.D. si në deklaratën e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 09.11.2009, në gjykatën komunale në Prizren. Edhe pse i padituri A.D. përmes kontratës që sipas ligjit prodhon efekt juridik është pronar i patundshmërisë kontestuese i njëjti ka theksuar gjithherë se kjo pronë por edhe pronat tjera janë pronë e përbashkët e familjes D. konkretisht pronë në pjesë të barabarta të trashëgimtarëve të ndjerit Sh.D. dhe se për pjesën ideale që i takon këtu paditësve të njëjtit trashëgimtarë ligjor të të ndjerit H.D. nuk ia ka kontestuar dhe nuk ia konteston asnjëherë. Këtë fakt se kjo pasuri dhe pronat tjera që figurojnë në emër të familjes D. janë prona të përbashkëta, të cilin fakt e kanë vërtetuar edhe trashëgimtarët tjerë, këtu nëna e të ndjerit H.D., A.D. si dhe dy motrat e të ndjerit S.B. dhe A.B. deklarata këto të cilat gjenden në

shkresat e lëndës, në procesverbalet e shqyrtimit kryesor. E gjithë pasuria e familjes D. e cila një pjesë e saj ende gjendet në emër të babait Sh.D. si dhe gjyshit të tyre, por edhe pasuria që figuron në emër të ndjerit H.D. është pasuri e fituar dhe e blerë në bashkësi familjare. Andaj nga këto rrethana gjykatës i ka propozuar që padia dhe kërkesë padia e paditësve të refuzohet si e pa bazuar.

Në fjalën përfundimtare, i autorizuari i të paditurit avokat B.K. ka theksuar se e kundërshton padinë e paditësve në tërësi si të pa bazuar me arsyetimin se i padituri A.D. është pronar juridik i paluajtshmërisë të cilën të drejtë e ka fituar në bazë të kontratës së legalizuar në Gjykatën Kompetente me nr. Leg.nr.II.47/2000. Po ashtu ka theksuar se e kontestojnë dhe e kundërshtojnë kontratën interne të vitit 1989 dhe 1998, me arsyetimin se kjo kontratë as për së afërmi nuk i ka plotësuar kushtet formale sipas dispozitave të Ligjit mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme e respektivisht kjo kontratë nuk është legalizuar që është kusht i domosdoshme që të prodhoh efektin juridik. Faktin se i padituri është pronar juridik i kësaj paluajtshmëri dhe ka lidhur kontratë të ligjshme për këtë paluajtshmëri edhe vetë paditësit nuk e kanë kundërshtuar të njëjtën e aq më tepër janë tërhequr nga anulimi i kësaj kontrate, por vetëm pa bazë ligjore kanë kërkuar vërtetimin e pronësisë me një kontratë interne e cila nuk i plotëson kushtet formale. Për veç tjerash edhe sikur kjo kontratë interne do të prodhonte efekt juridik palët ndërgjyqëse me deklaratat e tyre të dhëna kanë vërtetuar faktin se kjo pronë është blerë gjatë bashkësisë familjare dhe në kohën e blerjes ka ekzistuar bashkësia familjare dhe të gjitha blerjet e pronave të ndryshme kanë shkuar përmes këtu të ndjerit H.D. ngase i njëjti ka qenë zot shtëpie në familjen Dina, sepse të gjithë meshkujt tjerë, vëllezërit dhe babai i këtu H.D. kanë punuar dhe jetuar në botën e jashtme dhe të gjitha përfitimet dhe kontributet i kanë sjellë në shtëpi të cilat i ka menaxhuar i ndjeri H.D. Këtë fakt e kanë vërtetuar të gjithë dëshmitarët duke përfshirë këtu paditësen Z.D., V.D. dhe dëshmitarët tjerë si: A.D., S.B. dhe A.B. dhe nëna e palëve ndërgjyqëse A.D. Në fund gjykatës i ka propozuar që të merr vendim dhe kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar, ashtu si i ka specifikuar në fjalën përfundimtare.

2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik, sipas propozimit të palëve ka administruar provat relevante dhe atë: dëgjimi i dëshmitarit H.D. në shqyrtimin e datës 27.10.2023; leximi i procesverbalit të datës 24.08.2021; leximi i procesverbalit të datës 15.10.2021; leximi i ekspertizës të ekspertes së gjeodezisë T.K. e datës 18.10.2019; leximi i kontratës së datës 05.10.2000, e legalizuar pranë Gjykatës Komunale në Prizren, me nr.Leg.II.nr.47/2000 me datë 09.10.2000; leximi i kontratës së datës 24.06.1989 në mes të D.G. si shitës dhe H.D. si blerës; leximi i kontratës së datës 19.06.1989, në mes të shitësve N. etj. dhe H.D. si blerës; leximi i ujdisë gjyqësore me shenjën C.nr.832/06, e datës 15.11.2007, në Gjykatën Komunale në Prizren; leximi i aktgjykimit me shenjën C.nr.60/03 i datës 08.07.2005 lëshuar nga Gjykata Komunale në Prizren; leximi i certifikatës së pronësisë për gastrën

katastrale me nr. P-05653-2 lëshuar me datën 15.12.2017 nga zyra katastrale në Prizren; leximi i deklaratës së dhënë nga paditësi V.D. me datën 02.04.2013 dhe e noterizuar me nr. LRP.nr.757/2013 me datë 02.04.2013 pranë zyrës së noteres S.S. në Prizren; leximi i procesverbalit të datës 09.11.2009, në të cilën është bërë dëgjimi i paditëses Z.D. në cilësi të palës; leximi i procesverbalit të datës 07.12.2009, në të cilën është bërë dëgjimi i të paditurit A.D. në cilësi të palës ndërgjyqëse; leximi i deklaratës së dhënë nga D.G. e datës 12.02.2002, e vërtetuar pranë gjykatës Komonale në Prizren me nr.699/2002 datë 12.02.2002; leximi i procesverbalit i datës 13.06.2013; leximi i deklaratës mbi bashkësinë familjare e dhënë nga paditësja Z.D. me datë 05.09.2002 dhe e datës 12.08.2008.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se:

kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Gjykata në shqyrtimin e datës 27.10.2023, ka bërë dëgjimin e dëshmitarit H.D. i cili paditësen e ka kumatë-bashkëshorte të ish-vëllait, ndërsa paditësit e tjera i ka nipa-fëmijë të vëllait, ndërsa të paditurin A.D. e ka vëlla. Dëshmitari H.D. pranë kësaj gjykate ka deklaruar se: “së bashku me dy vëllezër të tjerë emrat R.D. dhe A.D. kanë qenë duke punuar në Zvicër, ndërsa babai ka qenë në Gjermani, ndërsa si zot shtëpie prej vitit 1982 deri në kohën kur ka rënë dëshmor ka qenë si zot shtëpie në Kosovë. Paluajtshmëria kontestuese më sa më kujtohet është blerë në muajin Qershor të vitit 1989, ku një mik i vëllait – H. i kishte treguar se paluajtshmëria është në shitje dhe i njëjti i ka thënë se unë si bujk nuk mund të blejë të njëjtën por më duhet të konsultohem me babën dhe vëllezërit të cilët ndodhen në botën e jashtme. Vëllai H. i ka telefonuar babait duke i treguar për arën e cili ka ardhur në Kosovë për ta parë të njëjtën dhe ka biseduar edhe me ne ku na ka treguar se ara qenka e mirë dhe me çmim të volitshëm, ku edhe kemi vendosur që të njëjtën ta blejmë. Ara është blerë me monedhën gjermane (marka) në shumë prej 62.000,00 deri 70.000,00 marka gjermane, një pjesë të të cilave e ka pasur baba në Gjermani, ndërsa pjesa tjetër e ka marrë nga ne të cilit ishim duke punuar në Zvicër. Se kush e ka lidhur kontratën dhe kush e ka qitur paluajtshmërinë mbi veti unë nuk e di, pasi kam punuar dhe jetuar jashtë, ndërsa si zot shtëpie ka qenë vëllai i madh H.D. Dua të shtoj se pas blerjes së kësaj paluajtshmërie ne si familje kemi blerë edhe prona tjera, rreth 3-4 hektar tokë, dhe në të gjitha rastet na ka njoftuar vëllai H. se këto toka janë në shitje, ndërsa ne ja kemi dërguar parat për ta bërë pazarin, duke i thënë se a je ti shefi dhe nëse dëshiron ti ne ti dërgojmë parat për ti blerë”. Në pyetjet e parashtruara nga të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, dëshmitari ka deklaruar se vëllai më i madh i tyre ka qenë i ndjeri H.D. i njëjti ka punuar si bujk në fshat së bashku me motrat S. dhe A. si dhe ka qenë si zot shtëpie në Kosovë. Pasurinë të cilën e kanë në fshat është afërsisht 5-6 hektar tokë, ndërsa në Prizren 24 ari, sipas informatave të cilat ia ka dhënë në atë kohë i ndjeri H. Në bashkësi familjare kanë jetuar deri në vitin 2005, edhe kur ka dalur nga bashkësia shoqja e vëllait të ndjerë H.D. paditësja Z.D. (më gjerësisht si në deklarin e dëshmitarit në seancën e datës 27.10.2023).

Gjykata ka bërë leximin e procesverbalit të datës 24.08.2021, në të cilin është bërë administrimi i provave dhe atë: dëgjimi i dëshmitares A.D.

Dëshmitarja A.D. e cila është vjehrra e paditëses së parë dhe gjyshja e paditësve të tjerë si dhe nëna e të paditurit, në shqyrtimin e datës 24.08.2021, ka deklaruar se: “palujtshmërin kontestuese e kanë blerë fëmijët e mi krejt së bashku si dhe bashkëshorti jam. Bashkëshorti im dhe 3 djemtë e mi ishin jashtë ndërsa bashkëshorti i këtu paditëses ishte këtu në Kosovë me mua. Isha prezent në kohën kur disa persona erdhën në shtëpi për të shitur këtë palujtshmëri, i ndjeri biri im H. kishte deklaruar se unë nuk kam të holla më i dhënë por flasë me babain dhe me vëllezërit e mi dhe do ta blejmë këtë tokë. I ndjeri H. gjatë gjithë kohës ka punuar këtu në Kosovë. Pas një kohe nga gurbeti kanë ardhë bashkëshorti im dhe djemtë tjetër. Besa më kujtohet që bashkëshorti im në qafë e ka pas të varur çantën me para të cilat ja kishte dorëzuar H. dhe e kishte thënë se mundesh me bo pagesën e tokës. Pra sa e di unë kjo tokë është blerë bashkërisht nga krejt. Biri im H shitësve iu kishte thënë se unë para për me ble nuk kam por flasë me babain dhe vëllezërit në gurbet dhe nëse ta bien dakord atëherë unë ju paguaj nëse jo ska kurgjo”. Në pyetjet e parashtruara nga të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, dëshmitarja ka deklaruar se çmimi i shitblerjes së palujtshmërisë në fjalë sa i kujtohet ka qenë 60.000 apo 70.000, ndërsa valuta nuk i kujtohet.

Gjykata ka bërë leximin e procesverbalit të datës 15.10.2021, në të cilin është bërë administrimi i provave dhe atë: dëgjimi i dëshmitares S.B. dhe dëgjimi i dëshmitares A.B.

Dëshmitarja S.B. e cila është motra e bashkëshortit të paditëses së parë dhe halla e paditësve të tjerë si dhe motra e të paditurit, në shqyrtimin e datës 15.10.2021, ka deklaruar se “paluajtshmëria kontestuese sa më kujtohet është blerë në vitin 1989, ndërsa unë vetë jam martuar 1995. Vëllezërit bashkë dhe babai i kanë tubuar paret dhe bashkërisht e kanë blerë paluajtshmërinë, vëllau më i madhe apo bashkëshorti i paditëses ishte në Kosovë dhe bashkërisht me vëllezërit e tjerë e kanë blerë paluajtshmërinë. Sa më kujtohet mua toka është blerë 60 mijë DM të atëhershme, unë nuk isha prezent në marrëveshje por këto i di nga tregimet e familjarëve. Paret shitësve iu ka paguar vëllau më i madh H. pasi që në Kosovë ai ishte zoti i shtëpisë i cili gjatë gjithë kohës ka punuar në Kosovë”. Në pyetjet e parashtruara nga të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, dëshmitarja ka deklaruar se kjo paluajtshmëri nuk është evidentuar në emër të babës por në emër të vëllaut – H. për faktin se H. ishte i zoti i shtëpisë në Kosovë dhe të gjitha punët babai ia ka dorëzuar atij pasi që edhe vetë kishte punuar në shtetin e Gjermanisë. Tutje ka deklaruar se vëllai (H.), ka nderuar jetë me 24 Mars 1999, para se të nderon jetë kishte jetuar në fshatin Celinë dhe aty kanë jetuar të gjithë së bashku në bashkësi familjare.

Dëshmitarja A.B. e cila është motra e bashkëshortit të paditëses së parë dhe halla e paditësve të tjerë si dhe motra e të paditurit, në shqyrtimin e datës 15.10.2021, ka deklaruar se “paluajtshmëria kontestuese është blerë në vitin 1989, për blerjen e së cilës baba i kishte sjellur paratë nga Gjermania dhe atë shumën prej 60 mijë DM, se a i ka pas paret e veta apo ka marr nga vëllezërit nuk e di. Vëllai më i madhe H. ka jetuar në Kosovë dhe ishte i zoti i shtëpisë ndërsa babai dhe vëllezërit të tjerë kanë jetuar në botën e jashtme. H. i ka paguar paret të cilat

ia kishte dhënë babai i tij dhe i jemi. Këto të dhënat unë i kamë dëgjuar nga familjarët pasi që në atë kohë gratë nuk kanë marr pjesë në këto marrëveshje. Unë jam martuar në vitin 1998 deri sa babai dhe i ndjeri H. ishin gjallë”. Në pyetjet e parashtruara nga të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, dëshmitarja ka deklaruar se kjo paluajtshmëri nuk është evidentuar në emër të babës por në emër të vëllaut – H. për faktin se H.ka qenë zotë i shtëpisë në Kosovë. Vëllezërit e tjerë jetojnë në botën e jashtme një kohë të gjatë por koha e saktë nuk i kujtohet pasi që në atë kohë ishte shumë e re. Vëllai R. sa di dëshmitarja, atje ka shtëpi ndërsa vëllau H. ka banesë, Il. sa di nuk posedon asgjë. H. posedon shtëpi në fshatin ndërsa Il. ka shtëpi të cilën e ka ndërtuar pas luftës në Kosovë. H. ka jetuar në shtëpinë ku kanë jetuar bashkë, shtëpi kjo e cila është djegur në kohë të luftës dhe tash nuk posedon shtëpi por që tokë ka pasi që në vend dihet se ku është vendi i tij. Sa është sipërfaqja e tij nuk e di por sa e di është njëjtë sikurse edhe vëllezërit e tjerë.

Nga leximi i ekspertizës të ekspertes së gjeodezisë T.K. e datës 18.10.2019, gjykata vërtetoi faktin se bazuar në të dhënat të cilat disponon Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, ngastra kadastrale numër 5655-3, në vendin e quajtur Atmejdan, në sipërfaqe prej 697 m², me kulturë arë e klasës së dytë, evidentohet në emër të A.D. Me daljen në vend në prezencë të gjykatës, është bërë identifikimi i ngastrës kadastrale kontestuese dhe është konstatuar se sipërfaqja është e lirë pa objekte, pa të mbjella shumëvjeçare dhe e njëjta është tokë e papunuar. Ngastra kadastrale në anën veri-perëndimore kufizohet me ngastrën kadastrale nr.5653-2, në gjatësi prej 32.61 m, në lindje kufizohet me hekurudhën në gjatësi 48.95 m, në jug-lindje kufizohet me ngastrën kadastrale 5654-2, në gjatësi prej 21.27 m, ku sipërfaqja prej 57 m², shfrytëzohet si rrugë për të pasur qasje në ngastrat kadastrale 5653-3 dhe 5653-4, në të cilat janë të ndërtuara objektet familjare. Ekspertizës së datës 18.10.2019, ekspertja ia ka bashkangjitur edhe skicën me indikacione nga planet evidente, që posedonte Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër.

Nga leximi i kontratës së datës 05.10.2000, e legalizuar pranë Gjykatës Komunale në Prizren, me nr.Leg.II.nr.47/2000 me datë 09.10.2000, gjykata vërtetoi faktin se me datë 05.10.2000, ishte lidhur kontrata në mes të N.N., T.N., B.N., N.N., A.S. dhe M.S. të gjithë në cilësinë e shitësit, me këtu të paditurit A.D. në cilësinë e blerësit. Objekt i kësaj kontrate ishte ngastra kadastrale me numër 5655/3, në vendin e quajtur “Atmejdan”, arë e klasës së II, në sipërfaqe prej 6,97 ari. Në ditën e lidhjes së kësaj kontrate ishte paguar edhe çmimi i shitblerjes në lartësi prej 13,040 DM.

Nga leximi i kontratës së datës 24.06.1989, gjykata konstatoi faktin se me datë 24.06.1989, është lidhur kontrata në mes të D.I.G. nga Prizreni, si shitës dhe H.D. nga fshati komuna e Rahovecit si blerës. Kjo kontratë ishte lidhur në prani të dy dëshmitarëve I.G. dhe R.K. dhe objekt i kësaj kontrate ishte ngastra kadastrale me numër 5653, në vendin e quajtur “Atmejdan”, me sipërfaqe prej 0,23.00 ha, e të cilën blerësi do ta shfrytëzoj si qasje në rrugë, e cila fillon nga shinat e trenit dhe shkon pranë truallit të këtu blerësit në gjerësi prej 3 metrave, e të cilën rrugë e kalon blerësi si e përbashkët për këta persona pa pagesë. Kontraktuesit në prezencën e dëshmitareve të theksuar janë marrë vesh për caktimin e çmimit të shitblerjes për paluajtshmëritë të përshkuar si në nenin I të kësaj kontrate dhe janë marrë vesh dhe kanë caktuar çmimin e shitblerjes në shumë të përgjithshëm 440.000.000 mil dinarë nga të cilat

çmimin e shitblerjes blerësi ia ka paguar shitësit shumën prej 320.000.000 mil dinarë, kurse pjesën tjetër për pagesë 120.000.000 mil dinarë, blerësi ka mbete borxh t'ia paguan deri me 01.01.1990 dhe në këtë mënyrë do të paguhet në tërësi obligimi i blerësit ndaj shitësit.

Nga leximi i kontratës së datës 19.06.1998, gjykata vërtetoi faktin se me datë 19.06.1998, në Prizren, është lidhur kontrata në mes të N.N., T. N., B.N., N.N., A.S. dhe M.S. të gjithë nga Prizreni, si bashkëpronarë-shitës në një anë, H.Sh.D. nga fshati Komuna e Rahovcit, si blerës, si dhe D.I.G. nga Prizreni, si pagues në anën e tretë. Shitësit janë bashkëpronarë të parcelës kadastrale 5655/3, në vendin e quajtur "Atmejan", arë e klasës së II, në sipërfaqe prej 6.97 ari, e cila udhëhiqet sipas listës posedues Novi /8417/KK Prizren dhe të njëjtën me vullnetin e tyre ia shesin H.D. nga Çmimi i shitblerjes për parcelën kadastrale nga neni I i kësaj kontrate është 40.000 DM, në shumën neto, me atë që pagesa në dorë shitësve në ditën e lidhjes së kësaj kontrate e ka bërë D.G. në favor dhe për llogari të blerësit e të cilën palët e konfirmojnë me nënshkrimin tyre në këtë kontratë dhe në prani të dy dëshmitarëve të rritur. Konstatohet se parcela kadastrale nga neni I i kësaj kontrate gjendet në posedim të blerësit në mënyrë permanente nga data 24.06.1989, kur paguesi D.G. ka bërë pagesën çmimit të shitblerjes në datën e theksuar dhe të njëjtën ia ka dorëzuar blerësve me kontratë me shkrim, si posedues me mirëbesim dh në bazë të kontratës, i cili ndryshim i kontratës nuk është bërë në librat kadastral dhe se blerësi vazhdon që parcelën njëjtë në kuadër të kësaj kontrate ta shfrytëzoj si posedues është pronar i vetëm dhe ekskluziv. Tatimi në qarkullim për legalizimin kontratës së shitblerjes i paguan blerësi ashtu si është theksuar në kontratën e lidhur më herët me datën 24.06.1989.

Nga leximi i ujdisë gjyqësore me shenjën C.nr.832/06, e datës 15.11.2007, në Gjykatën Komunale në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se i autorizuari i të paditurit D.G. ishte pajtuar që paditësve Z.D., A.D., M.D., D.D., V.D.1., V.D.2., J.D. dhe V.D.3. duke mos ia konstestuar të rrejtën pronësore paditësve, nga baza e trashëgimisë në pjesën e parcelës kadastrale 5653, në sipërfaqe prej 0.15,07 ha, të cilat kanë qenë objekt i kontratës së shitblerjes të lidhur në mes të ndjerit H.D. dhe të paditurit D.G. si trashëgimtarë i të ndjerit I.G.

Nga leximi i aktgjykimit me shenjën C.nr.60/03, i datës 08.07.2005, lëshuar nga Gjykata Komunale në Prizren, gjykata konstatoi faktin se me këtë aktgjykim ishte aprovuar kërkesëpadia e paditësve Z., A., M., D., V.1., V.2., J., dhe V.D.3. , ishte vërtetuar se të të njëjtit janë trashëgimtar të vetëm të të ndjerit H.D. ish nga fshati në bazë të kontratës së shitblerjes e cila është lidhur në mes të tij dhe të paditurit D.I.G. pronarë i paluajtshmërisë së arës, kl. II, në vendin e quajtur "Atmejdan", në sipërfaqe prej 25.20m, e evidentuar si parcelë kadastrale 5653, duke obliguar të paditurit që të pranojnë dhe të lejojnë paditësit në kadastër si pronarë të kësaj ngastre, e më gjerësisht si në aktgjykimin e lartcekur.

Nga leximi i certifikatës së pronësisë për ngastrën kadastrale me nr. P-05653-2 lëshuar me datën 15.12.2017 nga zyra kadastrale në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se ngastra kadastrale me numër P-71813068-05653-2, evidentohet në emër të V (H) D.3.

Nga leximi i deklaratës së dhënë nga paditësi V.D. 3., me datën 02.04.2013 dhe e noterizuar me nr. LRP.nr.757/2013, me datë 02.04.2013, pranë zyrës së noteres S.S. në Prizren, gjykata konstatoi faktin se këtu paditësi V.D.4., kishte dhënë deklaratë pranë zyrës së Noteres, duke deklaruar se së bashku me agjallarët e tij dhe atë R. (Sh) D., A.(Sh) D. dhe H. (Sh) D. që të gjithë të lindur në komuna e Rahovecit, ishin dakorduar që tërë pasurinë trashëguar nga gjyshi i tij Sh.(S) D. ish nga fshati komuna e Rahovecit, pastaj pasurinë e fituar në bashkësinë familjare dhe atë sa ka qenë i gjallë Sh.D. si dhe pasurinë që kanë fituar pas vdekjes së tij, e cila pasuri gjendet ne fshatin si dhe trollin i cili gjendet në Prizren, në emër të këtu paditëses Z. në sipërfaqe afër 1600 m2, njëherë edhe trollin tjetër i cili është i regjistruar në emër të të paditurit A. (Sh) D. në sipërfaqe afër 700 m2, ne vendin e quajtur "Atmejdan" ZK Prizren, do të ndahet në 4 katër pjesë të barabarta (më gjerësisht si në deklaratën e lartcekur e cila gjendet në shkresat e lëndës).

Gjykata ka bërë leximin e procesverbalit të datës 09.11.2009, në të cilën është bërë dëgjimi i paditëses Z.D. në cilësi të palës. Paditësja Z.D. ka deklaruar se në vitin 1981 është martuar tani me të ndjerin H.D. me të cilin kanë 7 fëmijë, por kunor kanë lidhur në vitin 1985, meqenëse e njëjta për shkak të moshës nuk ka mund të lidhë kunorë atëherë kur janë martuar. E njëjta deklaron se burri i saj ka punuar në botën edhe para martesës edhe pas martesës, edhe 5 vjet pas martesës ka punuar në botën e jashtme. Por të hollat i ka mbajtur ajo dhe se i njëjti asgjë nuk ka mësuf prej paditëses. Kur është blerë patundshmëria kontestuese diku kah vitet 1989, prej të paditurit D.G. ka qenë prezent edhe paditësja kur të hollat në shumën prej 40.000 DM ia ka dhënë burrit në emër të blerjes së patundshmërisë, mirëpo sa e ka blerë dhe pse nuk e ka bërë bartjen nuk e din, meqenëse e njëjta ka qenë e angazhuar me fëmijët. Gjithashtu e njëjta deklaron se kanë jetuar në bashkësi familjare me kunatitë, mirëpo secili ka punuar për veti. Në pyetje të autorizuarit të palëve ndërgjyqëse, e njëjta deklaron se raportet me kunatitë nuk ka pasë- me A. edhe pasi ka krye këto ndryshime në kadastër i ka bartë në emër të vetë dhe se e ka informuar se krejt pasurin e ka qitë në emrin e tij dhe tash endu nëpër rrugë, për çka atëherë kam filluar të interesohet lidhur me këtë patundshmëri. Me anëtarët e tjerë të familjes e njëjta deklaron se me asnjërin nuk kam pasur raporte të mira as me vjehrrën as me kunetërit.

Gjykata ka bërë leximin e procesverbalit të datës 07.12.2009, në të cilën është bërë dëgjimi i të paditurit A.D. në cilësi të palës ndërgjyqëse. I padituri A.D. ka deklaruar se: "babai im 33 vjet ka punuar ne Gjermani deri ne vitin 1998, kur ka dalë në pension ndërsa sa i përket vëllezërve tjerë R. është prej 1978, ku edhe sot e punon, gjithashtu edhe vllau i vogël H.D. prej vitit 198 punon ne Zvicër i cili është ende atje, ndërsa unë kam punuar ne Zvicër prej 1985 deri në vitin 1999, kur më është vra vllau i ndjeri H. përndryshe bashkëshorti i paditëses, gjithashtu edhe gjatë luftës është vra babi im Sh. kështu jam detyruar të kthehem dhe të behet zot shtëpie, pra kam vazhduar kur ka lënë i ndjeri H. i cili ka qen si zot shtëpie, udhëheqës i familjes ton. Deklaroj se ne fshatin kemi blerë 7 hektar tokë me të hollat të cilat i kemi përfitu bashkërisht në botën e jashtme. Çdo herë që kemi blerë tokë vllau i ndjeri H. na lajmëronte dhe na tregojte për çmimin, si zot shtëpie kemi pas besim dhe kemi lënë atij i qojshim të hollat e ai pagonte. Gjithashtu edhe ngastrën kontestuese më kujtohet fare mirë në vitin 1989 krejt sipërfaqen prej 23 ari e kemi blerë në shumën prej 62.000 DM, më kujtohet baba më 20.06, po atij viti ka ardhur dhe ka pru të hollat. Si ndërmjetësues për blerjen e kësaj ngastre ka qenë

R.K. të cilit i kemi dhënë 1000 DM bakshish që keni blerë tokë, gjithashtu 1 ari tokë i njëjti ka marrë prej D.G. të cilën tokë ka shitur neve. Andaj, me plotë përgjegjësi deklaroj se kjo prej ngastër është blerë me të hollat e përbashkëta të familjes tonë, gjithashtu edhe një herë deklaroj se nuk ia mohojmë as unë as anëtarët tjerë pjesën e të ndjerit H. familjarëve të tij. Dhe atë në tërë patundshmërinë e trashëguar dhe të blerë diku rreth 7 hektar në komunën kadastrale si dhe kjo e blenja në Prizren deklaroj se 1/4 ia pranojmë paditëses Z.D. gjegjësisht trashëgimtarëve të vllahut të nder H.

Nga leximi i deklaratës së dhënë nga D.G. e datës 12.02.2002, e vërtetuar pranë gjykatës Komonale në Prizren me nr.699/2002 datë 12.02.2002, gjykata konstatoi faktin se i njëjti kishte deklaruar se sipas kontratës së datës 24.06.1989, ngastra kadastrale arë e klasës së II, në vendin e quajtur “atmejdan”, me numër 5653, sipas listës me numër 459, komuna e Prizrenit, është në sipërfaqe të përgjithshme prej 25,20 ari, ndërsa blerësit Il.(Sh) D. nga fshati i takon vetëm 16,00 ari. Tutje kishte deklaruar se blerësi ia kishte paguar të gjithë çmimin e blerjes dhe se ngastra kadastrale ishte në emër të babait të ndjerë I.

Gjykata ka bërë leximin e procesverbalit të datës 13.06.2013, në të cilën është bërë: leximi i kontratës mbi shitblerjen e datës 24.06.1989; certifikata e vdekjes për H.D. aktvdekja për të ndjerin si dhe certifikatat e lindjes dhe certifikata e martesës; shikimi në kopjen e planit që është e datës 06.10.2003, e përpiluar nga shërbimi i gjeodezisë dhe kadastrit Komuna e Prizrenit; leximi i procesverbalit mbi shikimin e vendit të bërë nga gjykata me datë 08.04.2003; leximi i kontratës mbi shitblerjen e datës 20.06.1989; deklarata e dhënë nga D.G. e datës 12.02.2002; deklarata e dhënë nga V.D. me datë 02.04.2013; leximi i dëshmisë së deponuar nga dëshmitarja e dëgjuar A.D. e dhënë me datë 16.12.2009; leximi i dëshmisë së dhënë nga Z.D. në cilësi të palës në Procesverbalin e datës 09.11.2009; leximi i vendimit C.nr.493/08, i datës 09.11.2009, lidhur me refuzimin e dëshmitarëve të propozuar nga palët.

Nga leximi i certifikatës së vdekjes për H.D. me numër serik V 0023735, të datës 12.08.2008 dhe certifikatës së martesës me numër serik M 0060137, të datës 12.08.2008, gjykata vërtetoi faktin se H.D. ish nga fshati Celinë, kishte vdekur me datë 25.03.1999 dhe i njëjti ka qenë i martuar me këtu paditësen Z.D.

Gjykata ka bërë shikimin në kopjen e planit që është e datës 06.10.2003, e përpiluar nga shërbimi i gjeodezisë dhe kadastrit Komuna e Prizrenit, në të cilën konstatohet se shfrytëzuesi I.D.G. kishte paraqitur Kopjen e Planit për pjesën e ngastrës kadastrale 5653, me sipërfaqe 3,98 ari, 5653, me sipërfaqe 15,37 ari dhe 5653 me sipërfaqe 5,85, apo me sipërfaqe të përgjithshme 25,20 ari.

Nga leximi i procesverbalit mbi shikimin e vendit të bërë nga gjykata me datë 08.04.2003, është konstatuar se gjykata së bashku me ekspertin T.K. ka dalë në shikim në vend të ngjarjes dhe është bërë identifikimi i ngastrës kadastrale numër 5653 KK Prizren, e cila evidentohet në listën poseduese numër 459, me kulturë arë e klasës II, në sipërfaqe prej 25.20 ari, në emër të I.D.G.

Nga leximi i vendimit C.nr.493/08, i datës 09.11.2009, të marrë në procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 09.11.2009, gjykata konstatoi faktin se ishte aprovuar propozimi i të autorizuarit të paditësve për mosdëgjimin e të paditurve D.G. dhe A.D. si palë, ndërsa ishte refuzuar propozimi i të autorizuarit të paditësit për dëgjimin e dëshmitarëve S., Sh., A. dhe A.D. si dhe i vëllezërve R., Sh. dhe H.D.

Nga leximi i deklaratës mbi bashkësinë familjare e dhënë nga paditësja Z.D. me datë 05.09.2002 dhe e datës 12.08.2008, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka jetuar në bashkësi familjare me paditësit e tjerë dhe atë A.D.-e bija, M.D.-e bija, D.D.-e bija, V.D.1.,-e bija, V.D.2.,-e bija, J.D.-e bija dhe V.D.3.-i biri.

3.Baza ligjore

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, është me rëndësi të theksohet se në nenin 1 të Protokollit shtesë të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut përcaktohet se “*çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t’i respektohet pasuria e tij*”. Pastaj, edhe sipas nenit 46 par. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës parashihet që “e drejta e pronës është e garantuar”.

Në këtë drejtim, Ligji për Trashëgiminë i Kosovës, të datës 30 dhjetor 1974 (Gazeta Zyrtare e KSAK), në nenin 2 ka paraparë “*Pasurinë trashëgimore të të vdekurit e trashëgojnë para të gjithëve fëmijët e tij dhe bashkëshorti i tij. Ata trashëgojnë në pjesë të barabarta*”.

Sipas nenit 20 par. 1 të Ligjit mbi marrëdhëniet themelore juridike-pronësore (LMThJP) nr. 827 të datës 30.01.1980 përcaktohet se “*e drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim*”. Ndërsa, në paragrafin 2 të nenit të lartcekur të LMThJP-së parashihet që “*e drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj*”. Pastaj, me nenin 21 të LMThJP-së theksohet që “*sipas vetë ligjit e drejta e pronësisë fitohet me krijimin e sendit të ri, me bashkim, me përzierje, me ndërtim në tokën e huaj, me ndarjen e fryteve, me parashkrimin fitues, me fitim të pronësisë nga jo pronari, me okupim dhe në raste të tjera të caktuara me ligj*”.

Në anën tjetër, me nenin 326 të Ligjit mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare (LMMF) nr. 10 të datës 28.03.1984, përcaktohet që “*kur në bashkësinë familjare në mes të bashkëshortëve përkatësisht bashkëshortit jashtë martesorë jetojnë fëmijët e tyre dhe personat tjerë në gjini të cilët punojnë në pasurinë e përbashkët bujqësore ose bashkërisht ushtrajnë veprimtaritë e tjera ose në ndonjë mënyrë tjetër punojnë bashkërisht, pasuria e fituar gjatë vazhdimit të asaj bashkësie është pasuri e përbashkët e të gjithë anëtarëve të bashkësisë familjare, të cilët kanë marrë pjesë në fitimin e saj*”. Në nenin 327 par. 1 të LMMF-së, parashihet që “*pasurinë e përbashkët anëtarët e bashkësisë familjare e administrojnë dhe e disponojnë bashkërisht dhe me marrëveshje*”. Me nenin 328 par. 2 të LMMF-së thuhet që “*nëse në ato regjistra është regjistruar si pronar një anëtar i bashkësisë familjare ose anëtarët e caktuar të bashkësisë familjare, gjithnjë derisa, sipas propozimit të anëtarëve të tjerë të bashkësisë familjare, në regjistrat publik për evidencën e pasurive të paluajtshme, nuk regjistrohen faktet për të drejtën e pronësisë së përbashkët*”. Në vazhdim, me nenin 329 të LMMF-së, është paraparë se “*nëse*

me ligj nuk është caktuar ndryshe, për marrëdhëniet pasurore të anëtarëve të bashkësisë familjare nga neni 326 i këtij ligji aplikohen me analogji dispozitat mbi marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve”. Në këto rrethana, në nenin 306 të LMMF-së parashihet se çka përbën pasuri të veçantë, ndër të tjera edhe pasuria e fituar me anë të trashëgimit. Pastaj, në nenin 314 të ligjit të lartcekur parashihet pjesëtimi i pasurisë së përbashkët me marrëveshje, ndërsa në rast se nuk arrihet marrëveshja ndërmjet anëtarëve të familjes, një gjë të tillë e bënë gjykata në bazë të të gjitha rrethanave të rastit, duke marrë për bazë, por duke mos u kufizuar në udhëheqjen e punëve shtëpiake, kujdesin e ruajtjen e pasurisë së përbashkët dhe çdo formë e punës në administrimin, ruajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.

Ndërsa, me nenin 7 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se *“palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Me nenin 2 par. 2 të LPK-së është paraparë se *“gjykata i zbaton rregullat e të drejtës materiale sipas çmuarjes së saj dhe nuk është e lidhur me thëniet e palëve që kanë të bëjnë me të drejtën materiale”*.

4. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në këtë drejtim, gjykata pas administrimit të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesor, të propozuara nga pala paditëse dhe ajo e paditur, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar dhe si e tillë duhet të aprovohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestues fakti se i padituri A.D. evidentohet si pronar ligjor i paluajtshmërisë në ngastrën kadastrale P-71813068-0565-3 ZK Prizren, në vendin e quajtur “Atmejdan”, në sipërfaqe prej 697 m², arë e klasës së dytë. Po ashtu nuk ishte kontestuese se paditësit Z.D., A.D., M.D., D.D., V.D.1., V.D.2., J.D. dhe V.D.3. janë trashëgimtarët ligjor të të ndjerit Hamzë Dina, vëllai i këtu të paditurit.

Kontestuese në këtë çështje juridike ishte nëse paditësve Z.D., A.D., M.D., D.D., V.D.1., V.D.2., J.D. dhe V.D.3. që të gjithë me vendbanim në Prizren, i takon e drejta e pronësisë në ngastrën kadastrale P-71813068-0565-3 ZK Prizren, sipërfaqe prej 697 m², në pjesë ideale prej 1/8. Po ashtu, kontestuese ishte fakti se ngastra kadastrale 0565-3, a ishte pasuri e cila ishte fituar gjatë bashkësisë së përbashkët familjare në mes të vëllezërve.

Në këtë drejtim, gjykata në këtë çështje juridike fillimisht ka vlerësuar nëse paluajtshmëria e cila është objekt i këtij kontesti, është krijuar gjatë ekzistimit të bashkësisë familjare, nëse kjo paluajtshmëri paraqet pronësinë e përbashkët në bashkësi familjare.

Gjykata, ka konstatuar se paluajtshmëria në ngastrën kadastrale P-71813068-0565-3 ZK Prizren, evidentohet në emër të të paditurit A.D. fakt ky i konstatuar nga ekspertiza e gjeodezisë, e datës 18.10.2019, e ekspertes T.K. e administruar në këtë çështje juridike kontestimore. Nga provat e administruara, gjykata ka vërtetuar faktin se H.D. ish nga fshati

Celinë, komuna e Rahovecit dhe i padituri A.D. nga fshati komuna e Rahovecit, janë vëllezër, dhe se gjatë kohës sa të njëjtit kanë jetuar në bashkësi familjare dhe ekonomike, së bashku edhe me anëtarët e tjerë të familjes, gjatë vitit 1988-1989, me pasurinë e përbashkët të krijuar në bashkësi e kanë blerë edhe ngastrën kadastrale kontestuese. Ndërsa i padituri A.D. me datën 05.10.2000, në Prizren, ka lidhur kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, me N.N., T.N., B.N., N.N., A.S. dhe M.S., të gjithë në cilësinë e shitësit, të cilën kontratë e kanë legalizuar pranë Gjykatës Komunale në Prizren, dhe objekt i kësaj kontrate ishte ngastra kadastrale me numër 5655/3, në vendin e quajtur “Atmejdan”, arë e klasës së II, në sipërfaqe prej 6,97 ari, përmes të cilës dhe është regjistruar pronarë i kësaj ngastre.

Në anën tjetër, gjykata vlerëson se paditësve Z.D., A.D., M.D., D.D., V.D.1., V.D.2., J.D. dhe V.D.3. i takon e drejta e pronësisë në ngastrën kadastrale me numër P-71813068-5655-3, ZK Prizren, në pjesë ideale prej 1/32, si trashëgimtarë të të ndjerit H.D. emër të kontributit që i njëjti ka dhënë në bashkësinë familjare. Në të vërtetë, fakti se H.D. bashkëshorti i paditëses Z.D. dhe babai i paditësve të tjerë, ka qenë pjesë e bashkësisë familjare dhe ekonomike gjatë krijimit apo fitimit të paluajtshmërisë në fjalë, nuk mohohet as nga i padituri A.D. Po ashtu, gjykata në këtë çështje kontestimore ka bërë dëgjimin e dëshmitarëve A.D. e cila është nëna e të ndjerit H.D. dhe të paditurit A.D., S.B. dhe A.B. të cilat janë motrat e të ndjerit H.D. dhe të paditurit A.D. si dhe dëgjimin e dëshmitarit H.D. vëllai i të ndjerit H.D. dhe të paditurit A.D. Të gjithë dëshmitarë pranë kësaj gjykate kanë deklaruar se ngastra kadastrale kontestuese është blerë gjatë ekzistimit të bashkësisë familjare në mes të H.D. bashkëshorti i paditëses së parë dhe babai i paditësve të tjerë, si dhe anëtarëve të tjerë të familjes, përkatësisht këtu të paditurit A.D. dy vëllezërve të tjerë H. dhe R.D. prindërve të tyre dhe dy motrave, po ashtu kjo ngastër është blerë me kontributin e vëllezërve D. dhe babait të tyre.

Dëshmitarja A.D. e cila është nëna e të paditurit H.D. dhe nëna e paraardhësit të paditësve, pranë kësaj gjykate ka deklaruar se *“paluajtshmërin kontestuese e kanë blerë fëmijët e mi krejt së bashku si dhe bashkëshorti jam”*, duke shtuar se *“Isha prezent në kohën kur disa persona erdhën në shtëpi për të shitur këtë paluajtshmëri, i ndjeri biri im H. kishte deklaruar se unë nuk kam të holla më i dhënë por flasë me babain dhe me vëllezërit e mi dhe do ta blejmë këtë tok”*, dëshmisë të së cilës gjykata ia fali besimin e plotë pasi që ishte në përputhje edhe me deklaramet e dëshmitarëve të tjerë të dëgjuar në këtë çështje kontestimore, si dhe ishte fakt të cilën e njëjta e ka ditur pasi që ka qenë prezentë kur janë bërë bisedimet për blerjen e ngastrës kontestuese. Dëshmitarja S.B. pranë kësaj gjykate ndër të tjera kishte deklaruar se *“paluajtshmëria kontestuese sa më kujtohet është blerë në vitin 1989, ndërsa unë vetë jam martuar 1995. Vëllezërit bashkë dhe babai i kanë tubuar paret dhe bashkërisht e kanë blerë paluajtshmërinë”*. Po ashtu deklaratë të ngjashme ka dhënë edhe dëshmitarja A.B. e cila ka deklaruar se *“paluajtshmëria kontestuese është blerë në vitin 1989, për blerjen e së cilës baba i kishte sjellur paratë nga Gjermania dhe atë shumën prej 60 mijë DM, se a i ka pas paret e veta apo ka marr nga vëllezërit nuk e di. Vëllai më i madhe H. ka jetuar në Kosovë dhe ishte i zoti i shtëpisë ndërsa babai dhe vëllezërit të tjerë kanë jetuar në botën e jashtme. H. i ka paguar paret të cilat ia kishte dhënë babai i tij dhe i jemi”*. Po ashtu gjykata ka bërë dëgjimin edhe të dëshmitarit H.D. i cili pranë kësaj gjykate ndër të tjera ka deklaruar se *“së bashku me dy vëllezër të tjerë emrat R.D. dhe A.D. kanë qenë duke punuar në Zvicër, ndërsa babai ka qenë*

në Gjermani, ndërsa si zot shtëpi prej vitit 1982 deri në kohën kur ka rënë dëshmor ka qenë si zot shtëpie në Kosovë. Paluajtshmëria kontestuese më sa më kujtohet është blerë në muajin Qershor të vitit 1989, ku një mik i vëllait – H. i kishte treguar se paluajtshmëria është në shitje dhe i njëjti i ka thënë se unë si bujk nuk mund të blejë të njëjtën por më duhet të konsultohem me babën dhe vëllezërit të cilët ndodhen në botën e jashtme. Vëllai H. i ka telefonuar babait duke i treguar për arën i cili ka ardhur në Kosovë për ta parë të njëjtën dhe ka biseduar edhe me ne ku na ka treguar se ara qenka e mirë dhe me çmim të volitshëm, ku edhe kemi vendosur që të njëjtën ta blejmë. Ara është blerë me monedhën gjermane (marka) në shumë prej 62.000,00 deri 70.000,00 marka gjermane, një pjesë të cilave e ka pasur baba në Gjermani, ndërsa pjesa tjetër e ka marrë nga ne të cilit ishim duke punuar në Zvicër”. Deklaratave të dhëna nga këta dëshmitarë gjykata ia fali besimin e plotë dhe i çmoi si bindëse sa i përket kontributit të dhënë nga paraardhësi i këtu paditësve i ndjeri H.D. dhe i anëtarëve të tjerë të familjes të cilët kanë jetuar në bashkësinë familjare, në blerjen e kësaj ngastre kadastrale kontestuese, pasi që këto deklarata ishin në përputhje edhe me provat materiale të lartcekura, të cilat gjykata i ka elaboruar dhe shqyrtuar sa i përket çështjes së vlerësimit dhe identifikimit të pasurisë së përbashkët të krijuar gjatë bashkësisë familjare.

Faktin se ngastra kadastrale kontestuese ishte blerë gjatë ekzistimit të bashkësisë familjare, është vërtetuar edhe nga deklarimi i paditëses Z.D. në shqyrtimin e datës 09.11.2009, e cila ndër të tjera ka theksuar se ngastra kadastrale është blerë ka viti 1989 dhe se në atë kohë kanë jetuar në bashkësi familjare me kunetërit, mirëpo secili ka punuar për veti, deklarimit të së cilës gjykata pjesërisht ia fali besimin. E po ashtu edhe paditësi V.D. në deklaratën e tij me nr. LRP.nr.757/2013, të dhënë me datë 02.04.2013, pranë zyrës së noteres S.S. në Prizren, kishte deklaruar se me axhallarët e tij ishin dakorduar që pasurinë e cila ishte trashëguar nga gjyshi Sh.D. pasurinë e fituar në bashkësinë familje, ta ndajnë në katër pjesë të barabarta, ku sipas kësaj deklarate kjo pasuri përfshinte edhe pasurisë e cila ishte e regjistruar në emër të këtu të paditurit Alemi dina, në vendin e quajtur “Atmejdan”, me sipërfaqe afër 700 m², e cila paraqet ngastrën kadastrale kontestuese në këtë çështje konstesimore.

Faktin se i padituri A.D. dhe vëllezërit e tij dhe babai i tyre, kanë jetuar jashtë vendit, nuk merret si rrethanë se të njëjtit janë shkëputur nga bashkësia familjare, pasi që bazuar edhe në provat e administruara në këtë çështje kontestimore, është provuar fakti se të njëjtit kanë kontribuar në krijimin e pasurisë së përbashkët të familjes. E po ashtu edhe fakti se ngastra kadastrale kontestuese me numër 5655-3, në sipërfaqe prej 697 m², evidentohet në emër të të paditurit A.D. e njëjta nuk paraqet pengesë që paditësit të regjistrohen si pronarë në bazë të kontributit të bashkëshortit, respektivisht paraardhësit të tyre në krijimin e kësaj pasurie.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ku pjesën e kërkesës së paditësve që të njëjtit të regjistrohen si pronarë përtej pjesës së aprovuar si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e deri në pjesën ideale të kërkuar nga 1/8, të pjesës ideale të ngastrës kadastrale numër 5655-3 ZK Prizren, e refuzoi si të pabazuar, pasi që paditësit nuk kanë arritur që të provojnë faktin se ngastra kadastrale kontestuese është krijuar vetëm me kontributin e paraardhësit të tyre. E bazuar nenin 7.1 të LPK-së, është paraparë që “Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të

propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla” ndërsa me nenin 319.1 të po këtij ligji parashihet që “Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta” ndërsa me nenin 322 par 1 dhe 2 parashihet që “1 Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës. 322.2 Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është genësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”. Në të vërtetë, pala paditëse nuk ka ofruar ndonjë provë të vetme, me të cilën do të vërtetohej që ngastra kadastrale nr. 5655-3, është krijuar vetëm me kontributin e paraardhësit të tyre dhe se kjo është pasuri e veçantë dhe nuk mund të vlerësohet si pasuri e përbashkët familjare.

Andaj, në përputhje me nenin 329 lidhur me nenin 326 dhe 306 të LMMF-së, gjykata ka gjetur se ngastra kadastrale nr. 5655-3, ZK Prizren, është pasuri e përbashkët e të gjithë anëtarëve të bashkësisë familjare, përkatësisht bashkëshortit të paditëses së parë dhe paraardhësit të paditësve të tjerë dhe e këtu të paditurit, dhe që të njëjtit kanë marrë pjesë në fitimin e saj. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se paditësit janë pronar në pjesën ideale prej 1/32, në ngastrën kadastrale nr. P-71813068-5655-3, pasi që kjo pasuri konsiderohet si pasuri e përbashkët e tyre e blerë sa kanë qenë duke jetuar në bashkësi familjare dhe mbi bazën e kontributit familjar të përbashkët të të gjithë anëtarëve të familjes, të cilët në forma të ndryshme kanë marrë pjesë në krijimin e saj. Përkatësisht, paditësit rezultojnë të jenë pronar në pjesë ideale prej 1/32, si trashëgimtarë të të ndjerit H.D. dhe në këto rrethana, gjykata ka vendosur si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit, duke aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit. Përkatësisht nga provat e administruara, dëgjimi i dëshmitarëve në këtë çështje kontestimore, konstatohet se përveç të ndjerit H.D. ish nga fshati komuna e Rahovecit dhe të paditurit A.D. në blerjen e ngastrës kadastrale kanë kontribuar edhe fëmijët e tjerë, vëllezërit e këtu të paditurit A.D. dhe H.D. dhe ngastra kadastrale kontestuese është pronë e përbashkët e tyre.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera të administruara në shqyrtim kryesor (aktvdekja për të ndjerin I.G. si dhe certifikatat e lindjes për familjarët e I.G. kontratën mbi shitblerjen e datës 20.06.1989), por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen ndryshe meritore të kësaj çështje juridike kontestimore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në pikën nën V. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, konform nenit 450 të LPK-së lidhur me nenin 452 par. 2 të LPK-së, pasi që pala paditëse vetëm pjesërisht ka pasur sukses në këtë procedurë gjyqësore.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në përputhje me nenin 2 të Ligji për Trashëgiminë i Kosovës, të datës 30 dhjetor 1974, nenin 306, 314, 326, 328 dhe 329 të LMMF-së dhe nenin 20 të LMThJP-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**

Numri i lëndës: 2019:098532
Datë: 01.02.2024
Numri i dokumentit: 05270391

2019:098532, 01.02.2024

G j y q t a r i

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.